VENDIM
Nr. 632, datë 25.9.2019

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA SHPËRBLIM, NGA DREJTORIA E SHËRBIMEVE QEVERITARE TE PARTIA "BINDJA DEMOKRATIKE", SI SELI, TË VILËS NR.1 DHE TË PALESTRËS NË KRAH TË SAJ, NË BLLOKUN E ISH-VILAVE GJERMANE, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "b", të nenit 22, të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, "Për partitë politike", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim, pa shpërblim, nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare te partia "Bindja Demokratike", si seli, të vilës nr. 1 dhe të palestrës në krah të saj, në bllokun e ish-vilave gjermane, Tiranë, sipas hartës treguese të regjistrimit e genplanit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Partisë "Bindja Demokratike" i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1, ta tjetërsojë atë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.
3. Shpenzimet operative i ngarkohen partisë "Bindja Demokratike" dhe detyrimet e tjera të përcaktohen në kontratën e huapërdorjes, që do të lidhet ndërmjet palëve, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.
4. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe


harta treguese e regjistrimit.pdf - Adobe Acrobat Pro
File Edit View Window Help
Create
Customize
Tools
Sign
Comment
HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJSHME
TIRANE
A. IDENTIFIKIMI I PASURISE
B. KUFIZIMET
C. PRONARET
Type here to search
3:16 PM
9/25/2019


genplan.pdf - Adobe Acrobat Pro
File Edit View Window Help
Create
Customize
Tools
Sign
Comment
GENPLAN PER DHENIE ME QERA TRS-T-14/VITI 2006
SHKALLA 1:500
OBJEKTI:
KOMPLEKSI I ISH VILAVE GJERMANE
RRUGA VLLEZERIT KONDI. TIRANE.
DREJTORI
ELSA MEKSI
TIRANE, JANAR 2006
Type here to search
3:17 PM
9/26/2019